



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



## **KUVENDI**

Në bazë të nenit 12.2 shkronja d të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, neneve 13.1 shkronja a dhe 44.1 të Ligjit për tokën bujqësore nr.02/L-26, nenit 6.2 dhe 8.6 të Udhëzimit Administrativ për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, nr.41/2006 i datës 27.12.2006 dhe neneve 15.2 shkronja d dhe 19 shkronja b të Statutit të Komunës së Podujevës, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 30 mars 2016, miratoi,

### **VENDIM**

### **PËR LEJIMIN E NDËRRIMIT TË DESTINIMIT TË PËRHERSHËM TË TOKËS BUJQËSORE NË TOKË NDËRTIMORE**

#### **Neni 1**

Faik Mursel Goxhufi nga fshati Koliq Komuna e Prishtinës, në cilësinë e pronarit, i lejohe ndërrimi i përherëshëm i destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të paluajtshmërisë së evidentuar sipas ngastrës kadastrale nr. 00047-6 kultura – bujqësore - arë kl. 1, vendi i quajtur Seishta-Përte Rruge në sipërfaqe prej 1040 m<sup>2</sup> certifikata pronësore nr. 08/714/41933/2015 e datës 20.04.2015 Zona Kadastrale Shakovicë.

#### **Neni 2**

Pronari, në emër dhe interes të të cilit bëhet ndërrimi i destinimit nga toka bujqësore në tokë ndërtimore obligohet që paluajtshmërinë përkatëse ta shfrytëzojë vetëm për ndërtimin e objektit për banim dhe afarizëm dhe nuk mund ta përdorë për qëllime të tjera.

#### **Neni 3**

Regjistrimin, në librat kadastral, të pronës përkatëse për ndërrim të destinimit nga toka bujqësore në tokë ndërtimore në emër të pronarit e bënë Drejtoria e Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë.

#### **Neni 4**

Vendimi bëhet përfundimtar pas plotësimit të kushteve të përcaktuara në nenin 8.6 të Udhëzimit Administrativ për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, nr.41/2006, përkatësisht pas marrjes së pëlqimit nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

#### **Neni 5**

Zbatimin e vendimit e bëjnë Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

#### **Neni 6**

Vendimi hynë në fuqi pas vlerësimit të ligjshmërisë përkatësisht regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në Web faqen zyrtare të Komunës.

**Nr. 01-006-26544**  
**Podujevë,**  
**30 mars 2016**



**Kryesuesi i Kuvendit**  
**Mehmet Gashi**



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosova

Qeveria -Vlada-Government


Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor /Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja/Ministry of Environment and Spatial Planning

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : PODUJEVË  
Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Shakovicë

Njesia/Jedinica/Unit	Tip/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Površina/Area m2
P-71712082-00047-6	Pracelë / Parcela / Parcel	1040,0



Shkalla/Razmera/Scale: 1:1000

Punoi/Obradio/Created:  
 Data/ Data/Date: 20 04 2015  
 Koha/ Vreme/ Time: 11:19:03  
 Nënshkrimi/Potpis/Siganture:  
 Shënim/Beleška/Note:

Aprovoi/Usvojio/Approved MCO PODUJEVË director  
 Nënshkrimi/Potpis/Siganture:

